



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

**PROJEKTI FITUES ME TITULL:**

**“Hartëzimi i kompetencave kyçe dhe rezultateve të të nxënit  
në programet e mësuesisë, me fokus formimin e  
kompetencave profesionale të studentëve të mësuesisë të  
Universitetit të Tiranës”**

**(HK-RN-SUT)**

**FINANCUAR NGA UNIVERSITETI I TIRANËS  
NË KUADËR TË PROGRAMIT “UT-KËRKIM, EKSELENCË DHE INOVACION”  
2023**

**EKIPI I PROJEKTIT:**

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha (Udhëheqëse e projektit) – FGJH, UT

Prof. Dr. Andromaqi Haloçi – FGJH, UT

Prof. Asoc. Dr. Leticja Gusho – FSHS, UT

Prof. Asoc. Dr. Çlirim Duro – UT

Dr. Blerina Hamzallari – FSHS, UT

Msc. Sema Hysa – FGJH, UT

Msc. PhDc. Enkelejda Bara – UT

## **Aktiviteti 2: Metodologjia e Kodifikimit dhe mbledhjes së të dhënave nga dy programet e mësuesisë**

Në funksion të këtij qëllimi, fillimisht u ndërtua struktura e matricës për mbledhjen e të dhënave të dy programeve të mësuesisë, AML: Mësues i Gjuhës së Huaj Frënge dhe AML: Mësues i Biologjisë.

Në këtë takim u përcaktua tipi i të dhënave të cilat do të mblidhen. Në të dy strukturat e renditën standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar. Gjithashtu u renditën dhe lëndët të cilat ofrohen në të dy programet e studimit, për të dy blloqet, si për bllokun e formimit psiko-pedagogjik, ashtu edhe për bllokun e formimit shkencor të disiplinës specifike që po merret në analizë.

U përcaktua mënyra e kodimit të të dhënave. Pasqyrimi i indikatorëve është realizuar në mënyrë që kompetenca apo rezultati i të nxënit nuk pasqyrohet kjo është reflektuar me kodin “0”, nëse kompetenca ose rezultati i të nxënit pasqyrohet deri në masën 5% deri në 25%, kjo është përcaktuar me kodin “1”, nëse kompetenca ose rezultati i të nxënit pasqyrohet nga 30% deri në 50%, kjo është përcaktuar me kodin “2”, nëse kompetenca ose rezultati i të nxënit pasqyrohet deri në masën 75%, kjo është përcaktuar me kodin “3”, dhe nëse kompetenca ose rezultati i të nxënit pasqyrohet mbi masën 75%, kjo është përcaktuar me kodin “4”.

U realizua triangulimi i rezultateve të të nxënit, të parashikuara në programet mësimore, veprimtaritë ose aktivitetet akademike si edhe standardet e mësuesit.

## **Aktiviteti 3: Takime në lidhje me diskutimin e të dhënave të mbledhura**

Gjatë periudhës së analizës së të dhënave janë zhvilluar disa takime të ekipeve të veçanta të cilat kanë identifikuar, mbledhur dhe reflektuar të dhënat specifike në matricat e dakordësuara më parë. Gjithashtu janë realizuar dhe disa takime të grupit të projektit për të diskutuar mbi të dhënat e mbledhura.

Më datë 19.09.2023, grupi i punës u mbledh për të diskutuar mbi analizën e programeve lëndore për programin e ciklit të dytë Master i Shkencave për “*Mësuesi në Arsimin e mesëm të lartë në Gjuhë-Letërsi Frënge*” dhe “*Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Lartë në Biologji*”. Kjo analizë është bazuar në funksion të përmbushjes së kompetencave profesionale të përcaktuara në dokumentin e “Standardeve të Përgjithshme dhe Specifike të Mësuesit”.

Në muajin nëntor 2023 u realizuan tri analiza, mbi:

1. Krahasimin e syllabuseve me Standartet e përgjithshme të mësuesit;
2. Krahasimin e syllabuseve me Standartet specifike të mësuesit (për secilin program);
3. Krahasimin e syllabuseve me Kompetencat sipas Kuadrit Evropian.

